



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

**Bordi**

**VENDIM**

**Nr. 129, Datë 04.06.2018**

**MBI**

**MIRATIMIN E KODIT TË RRJETIT MBI KËRKESAT PËR LIDHJEN ME  
RRJETIN E GJENERUESVE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 23, gërma “b” të Ligjit nr. 43/2015 “*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*”, i ndryshuar; nenit 26 të “*Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE*”, miratuar me Vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, si dhe parashikimeve të Vendimit nr. 2018/03/PHLG-EnC, datë 12.01.2018 të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë, Bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 04.06.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike, mbi miratimin e Kodit të rrjetit mbi kërkesat për lidhjen me rrjetin të gjeneruesve,

**Dhe duke marrë në konsideratë:**

- Se Shqipëria është anëtare e Sekretariati të Energjisë që nga data 01.07.2006;
- Rregulloren e (BE) nr. 714/2009, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropës;
- Kërkesat e Rregullores së Komisionit (KE) 2016/631 e datës 14 Prill 2016 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropës;
- Vendimin nr. 2018/03/PHLG-EnC, datë 12.01.2018 të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë;
- Parashikimet e Ligjit nr. 43/2015, “*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*”, ndryshuar;
- Certifikimin operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a;
- Operatori i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a është anëtare me të drejta të plota e ENTSO-E;
- Sipas Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, ky Kod duhet të transpozohet pa ndryshuar tekstin apo strukturën e tij. Dispozitat e këtij Kodei do të prevalojnë ndaj Kodit të Transmetimit miratuar me vendimin nr. 186, datë 10.11.2017, të Bordit të ERE dhe çdo akti tjetër rregullator i sektorit të energjisë.
- Sa më sipër Bordi i ERE me vendimin nr. 100 datë 30.04.2018, filloi procedurën për miratimin e Kodit të rrjetit mbi kërkesat për lidhjen me rrjetin të gjeneruesve”

- Në vijim të vendimmarrjes sipërcituar ERE me shkresën nr. 50/25 Prot., datë 07.05.2018, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e procedurës dhe me shkresën nr. 383 Prot., datë 11.05.2018, bëri me dije palët e interesit, për vendimin e fillimit të procedurës për këtë Kod.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE,

**Vendosi:**

1. Të miratojë Kodin e rrjeti mbi kërkesat për lidhjen me rrjetin të gjeneruesve. (bashkëlidhur në gjuhën origjinale angleze dhe në shqip).
2. "Për të njëjtat parashikime, dispozitat e këtij Kodi do të prevalojnë ndaj Kodit të Transmetimit miratuar me vendimin nr. 186, datë 10.11.2017, të bordit të ERE dhe çdo akti tjetër rregullator në sektorin e energjisë elektrike".
3. Versioni në gjuhën e origjinës (Anglisht), ka përparësi në rast mosdakordësie në interpretim nga palët
4. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për Vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari**  
**Petrit AHMETI**